

Të rrisni biznesin tuaj të konsulencës? *Mësoni se si.*

Përmes diagnostikimit të asaj që i nevojitet një biznesi, deri tek zotërimi i shkrimit të një propozimi fitues, mësoni për aftësitë që ju nevojiten për të filluar, zhvilluar profesionalisht dhe ktheni përvojën tuaj në një biznes konsulence fitimprurës.



Ekipi për Mbështetjen e Biznesit të Vogël
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
FAH 122, 1st floor, Fushe Kosovo, 10600 Kosova
T +381 38 24207000 F +381 38 24207000
E knowhowkosovo@ebrd.com W ebrd.com/knowhow




European Bank
for Reconstruction and Development

Që prej fillimit të një biznesi konsulence, e deri tek dhënia e këshillave për praktikatat më të mira, ne *dimë se si*.

Që prej fillimit të një biznesi konsulence, e deri tek dhënia e këshillave për praktikatat më të mira, ne dimë se si.

Seria e “Rrisni Biznesin tuaj të Konsulencës” është një paketë me kurse trajnuese që ndan aftësi, burime dhe teknika thelbësore për këshillim efektiv dhe me impakt, si dhe për drejtimin e një biznesi të suksesshëm konsulence. Kurset ofrojnë njohurinë e domosdoshme për të kaluar që nga fillimi i një karriere këshilluese, deri tek drejtimi i biznesit fitimprurës, dhe do t’u ndihmojnë që të ofroni këshilla të cilësisë shumë të lartë për të cilën bizneset e vogla dhe të mesme janë të gatshme që të paguajnë.

Cilido qoftë niveli i përvojës suaj, kurset tona trajnuese ofrojnë instrumentat më të mirë të këshillimit për t’ju ndihmuar



që të shpini përpara ambiciet tuaja, dhe të ndërtoni një biznes konsulence të qëndrueshëm. Pra, nëse jeni një ekspert që kërkon të përdorni atë njohuri si konsulent profesional, apo një konsulent i ri që kërkon të zhvillojë aftësitë këshilluese, përvoje të gjatë në një firmë këshilluese i etur që të mësojë rreth specializimeve të reja, ose pronar i një biznesi konsulence që kërkon të përmirësojë modelin e biznesit të tij, merrni trajnimin që ju nevojitet për të arritur qëllimin.

Janë gjashtë kurse:

- Nisja e një biznesi konsulence
- Bazat e konsulencës për menaxhim
- Menaxhimi i një biznesi konsulence
- Marketingu dhe shitja e shërbimeve të konsulencës
- Diagnostikim biznesi për konsulencë
- Menaxhimi i projektit të konsulencës.

Ju mund të merrni një kurs, ose katër, ose që të gjashtë, varet prej jush dhe asaj për të cilën keni nevojë. Falë mbështetjes bujare të donatorëve tanë, ne ju japim çmim të ulur për pjesëmarrjen në secilin kurs. Për më shumë informacion rreth kursit dhe mënyrës së regjistrimit, ju mund të na kontaktoni përmes telefonit ose email-it, ose të vizitoni www.ebrd.com/knowhow/consultant

Themelet e konsulencës

Bazat e konsulencës për menaxhim

Ky kurs 5 ditor ofron një vështrim të plotë për pikat thelbësore të konsulencës për menaxhim. Që prej shkrimit të një propozimi fitues, e deri tek menaxhimi i marrëdhënieve me klientët dhe themelet e menaxhimit të projektit, mësoni se si të ofroni këshilla me cilësi të lartë në pajtueshmëri me standardet e industrisë.

Praktika juaj e konsulencës

Nisja e një biznesi konsulence

Nëse keni njohuri biznesi ose përvojë teknike që ju besoni se është e vlefshme për bizneset e vogla dhe të mesme, ky kurs dy ditor do t’ju ndihmojë të mësoni se si ta ktheni atë në një biznes të suksesshëm konsulence. Që prej aspekteve ligjore të nisjes së një biznesi, e deri tek fitimi i klientëve tuaj të parë dhe aftësive thelbësore për menaxhimin e biznesit, mësoni se si të përdorni përvojën tuaj për të ofruar këshillë me cilësi të lartë për të cilat bizneset e vogla janë në gjendje të paguajnë.

Menaxhimi i një biznesi konsulence

Perfeksiononi aftësitë tuaja të menaxhimit të biznesit me një kurs treditor për pronarë dhe menaxherë të bizneseve të konsulencës. Që prej gjetjes së grupeve të klientëve të rinj, deri tek menaxhimi i talentit dhe burimeve, mësoni se si ta bëni biznesin tuaj më efektiv, më konkurrues dhe më fitimprurës.

Marketingu dhe shitja e shërbimeve të konsulencës

Për shumë biznese të vogla dhe të mesme, angazhimi i një konsulenti të jashtëm nuk është diçka që ata e kanë shqyrtuar ndonjëherë. Që prej të dëgjuarit të zërit tuaj dhe deri tek hartimi i propozimeve fituese dhe menaxhimit të marrëdhënieve me klientët, ky kurs 4 ditor do t’ju ndihmojë që të tregtoni shërbimet tuaja këshilluese më gjerësisht dhe në mënyrë më efektive dhe të tërhiqni më shumë klientë

Aftësi këshilluese të thelluara

Diagnostikim biznesi për konsulencë

Që prej përzgjedhjes deri tek aplikimi i mjeteve të diagnostikimit, mësoni se si të identifikoni rrënjët e problemeve të klientit tuaj dhe t’u rekomandoni zgjidhjet e duhura. Duke u fokusuar në zbatim, ky kurs 3 ditor forcon aftësitë tuaja analitike dhe këshilluese, duke ju ndihmuar të jepni rezultatet që janë me të vërtetë të rëndësishëm për klientin tuaj.

Menaxhimi i projektit të konsulencës

Ky kurs 4 ditor ju ofron njohuri për menaxhimin e projektit, të cilat janë të domosdoshme për ofrimin me efektivitet të projekteve cilësore. Zhvillonin instrumenta për idetë, metodologjitë, kornizat dhe proceset e hartuara për t’ju ndihmuar që të plotësoni kërkesat e projekteve këshilluese të sofistikuar dhe për të ofruar projekte më të mëdha dhe më komplekse për klientët tuaj.